



Pranimi / Dorëzimi Prinyimje / Predato Review / Delivery	11. 02. 2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. to Prot. Prot. No	Shtypja Printuj Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHELL	603/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.01/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave** në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.01/2021 të datës 31.12.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga “Lekë Dukagjini”, Nr. 124 në Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.02.2021, mori këtë

**V E N D I M**

**I.APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.01/2021 e datës 31.12.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

**II.SHFUQIZOHET** Përgjigja e datës 01.10.2020 e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

**III.OBLIGOHET** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin [redacted] në pozitën “Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të Drurit” në Drejtorinë e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës sipas Akt Emërimit ZPD:280/2013 të datës 31.12.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

**IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**V.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit**

## Ar sy e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.01.2019 ka nxjerr Vendim A.nr.789/2018 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e datës 21.11.2018 të ankuesit duke e ndryshuar Vendimin Ref. SBNJD-219/2018 të datës 06.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe duke bërë ndryshimin e masës disiplinore nga *“largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për 4.5 vite”* në masën disiplinore *“largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”*. Në kuadër të kësaj më datë 30.01.2019 Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës ka nxjerr Vendim Ref: KE-58/19 për zbatimin e vendimit të Këshillit.

Pas kalimit të periudhës së masës disiplinore ankuesit më datë 25.09.2020 ka parashtruar kërkesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës për kthim në vendin e punës sipas akt emërimit. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës më datë 01.10.2020 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij.

Ankuesi kundër kësaj përgjigje, më datë 31.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 15/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet se përgjigja e datës 01.10.2020 nuk ka këshillë juridike dhe të kthehet në vendin e punës pas kalimit të masës disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 08.01.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Këshilli më datë 18.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 31.12.2020 me numër protokollit 15/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 01.01.2020 nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Vendimin Ref:KE-58/19 i datës 30.01.2019 i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Vendimin A.nr.789/2018 i datës 14.01.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 14.09.2018 për transferimin e nëpunësit civil; Akt Emërimit e datës 31.12.2012 të ankuesit; Kërkesën e datës 25.09.2020 për kthim në vendin e punës *“Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të Drurit”* dhe Përgjigjen në ankesë e datës 18.01.2021 nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke i analizuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 31.12.2012 ka qenë i punësuar në pozitën Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të Drurit” në Drejtorinë e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës, mirëpo sipas Vendimit Ref. SBNJD-129/2018 të datës 06.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës i është shqiptuar masa disiplinore *“largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për 4.5 vite”*, ndërsa pas procesit të ankimimit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.01.2019 ka nxjerr Vendim A.nr.789/2018 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e datës 29.11.2018 të ankuesit duke e ndryshuar Vendimin Ref. SBNJD-219/2018 të datës 06.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe duke bërë ndryshimin e masës disiplinore *“largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”*.

Meqenëse ankuesi pas kalimit të afatit të masës disiplinore nuk është kthyer në vendin e tij të punës, edhe pse më datë 25.09.2020 ka parashtruar kërkesë, atëherë sipas ankesës së ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i njëjti pretendon se përgjigja e datës 01.10.2020 nuk ka këshillë juridike, po ashtu kërkon kthim në vendin e punës.

Përgjigja e datës 01.10.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për ankuesin nuk përmban këshillë juridike se ku pala e pakënaqur ka të drejtë të përdor mjetet juridike të saj, atëherë mbi bazw tw kwsaj rrethane sipas dispozitave tw LPPA-sw“*nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj*” siç përcaktohet me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mbi këtë bazë edhe ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e afatshme në kuptim edhe të nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e anekseve, konstaton se ankuesit masa disiplinore “*largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për 4.5 vite*” i është shqiptuar më datë 06.09.2018 ndërsa me qëllim të zbatimit të Vendimit Ref. SBNJD-129/2018 të datës 06.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës ankuesi në bazë të Vendimit Ref:KE-561/18 të datës 14.09.2018 është transferuar në pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Prodhim Fidanor” në Drejtoratin për Hulumtime, Projektme në Pyje dhe Prodhim Fidanor në Pejë, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kthim në vendin e punës pas kalimit të afatit të masës disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse konstaton se në bazë të Vendimit A.nr.789/2018 të datës 14.01.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesit i është ndryshuar masa disiplinore në “*largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite*”, atëherë ka kaluar afati i vleftshmwirsw sw masës disiplinore për dy vite sepse koha e prodhimit tw efektit juridik tw vendimit tw komisionit disiplinor wshtw nga data14/09/2018, rrjedhimisht pas kalimit të afatit të masës disiplinore pasi që e njëjta është konsumuar, atëherë institucioni respektivisht Agjencia Pyjore e Kosovës ka qenë e obliguar që ankuesin ta kthej në vendin e tij të punës sipas kërkesës së tij, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës është i obliguar që ankuesin Xhezair Bibaj ta kthej në vendin e tij të punës në pozitën “Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunim të Drurit” në Drejtorinë e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës sipas Akt Emërimit ZPD:280/2013 të datës 31.12.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.01/2021, datë 11.02.2021

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Koosvës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Pyjore të Koosvës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.